



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:046867
Datë: 30.07.2024
Numri i dokumentit: 05999320
KPPP.nr.289/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbarimore të kreditorit “Vjosa 3” SH.P.K., me NUI: 810131053, me seli në Podujevë, përfaqësuar sipas autorizimit nga Arbër Jupolli, avokat nga Prishtina, kundër debitorit “Meli Farm” SH.P.K., me NUI: 811865841, me seli në Podujevë, fshati Sallabaj, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr.020/24 të datës 18.01.2024, të Përmbaruesit Privat Rezarta Metaj, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 30.07.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit “Meli Farm” SH.P.K., ANULOHET Urdhri Përmbarimor P.nr.020/24 i datës 18.01.2024, i Përmbaruesit Privat Rezarta Metaj, dhe PËRFUNDOHET në tërësi përmbarimi në këtë çështje përmbarimore.

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka caktuar urdhrin përmbarimor P.nr.020/24 të datës 18.01.2024, duke lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturës Nr.619-235-001-23 të datës 25.07.2023 dhe Faturës Nr.752-235-001-23 të datës 06.09.2023, me të cilin e ka detyruar debitorin që në emër të përmbushjes së obligimeve nga fatura, t’ia paguaj shumën e përgjithshme prej 6,112.69 €, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore dhe ato të përpilimit të propozimit për përmbarim në shumë prej 156.00 €, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë, me bartjen e mjeteve financiare nga llogaria bankare e debitorit në llogarinë e veçantë bankare të kreditorit, me regjistrimin, konfiskimin dhe shitjen e sendeve të luajshme dhe të paluajshme në pronësi të debitorit dhe pagesën e borxhit nga shitja e këtyre sendeve.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, e ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor duke theksuar se obligimi sipas faturave të cilat janë objekt i kësaj procedure përmbarimore është paguar paraprakisht me para kesh sipas praktikës së krijuar dhe kërkesës së kreditorit, andaj është e pa pranueshme që kreditori të lëshoj fatura, të mashtrtojë se të njëjta i ka dorëzuar tek debitori si dhe të kërkoj përmbushjen e tyre përmes përmbarimit. Tutje ka shtuar se lidhur me obligimin sipas faturave dhe faturat, debitori ka kuptuar vetëm pas pranimit të urdhrin përmbarimor, të njëjtat asnjëherë nuk i ka pranuar, nuk i ka nënshkruar, andaj si të tilla nuk mund të konsiderohen si dokumente të besueshme. I ka propozuar gjykatës që ta aprovoj prapësimin e debitorit, ta anuloj urdhrin përmbarimor.

Kreditori në përgjigje në prapësim, përmes përfaqësuesit të autorizuar ka theksuar se nuk qëndrojnë pretendimet e debitorit se faturat nuk i ka nënshkruar dhe pranuar asnjëherë, se obligimin e ka përmbushur me para kesh sipas praktikës mes debitorit dhe kreditorit, pasi që kreditori ka dëshmi se praktika e tillë e pagesës nuk ka qenë asnjëherë pasi që pagesat debitori çdoherë i ka realizuar përmes transaksioneve bankare. Tutje ka shtuar se debitori gjatë komunikimeve me kreditorin nuk e ka mohuar obligimin, po ashtu ka kërkuar kohë shtesë për pagesën e borxhit, po ashtu faturat të cilat janë objekt i kësaj procedure përmbarimore i janë dorëzuar edhe përmes postës në formë fizike dhe të njëjtat nuk janë kontestuar asnjëherë. I ka propozuar gjykatës që ta refuzoj prapësimin e debitorit.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbarimor duhet të anulohet, për arsyet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se: *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*. Me neni 37 të LPP-së, përcaktohet se: *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se dokumenti, përkatësisht Fatura Nr.619-235-001-23 e datës 25.07.2023 dhe Fatura Nr.752-235-001-23 e datës 06.09.2023, mbi bazën e të cilave është lejuar urdhri përmbartimor, nuk i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë dokumente të besueshme, për arsye se në rastin konkret nuk mund të vërtetohet se faturat në fjalë janë dorëzuar në mënyrë të rregullt nga ana e kreditorit dhe se të njëjtat janë pranuar nga debitori si në përmbajtje ashtu edhe për nga lartësia, për arsye se faturave ju mungon nënshkrimi apo vula e pranimi të debitorit.

Gjykata, ka vlerësuar edhe fletëkthesën e datës 01.11.2023, me numër 5621004, të cilën kreditori ia ka bashkangjitur propozimit për përmbartim dhe përmes së cilës pretendon se faturat mbi bazën e të cilave është lejuar urdhri i janë dorëzuar me rregull debitorit, mirëpo një dorëzim të tillë të faturave përmes postës gjykata nuk mund ta konsideroj si dorëzim të rregullt dhe pranim të faturave nga ana e debitorit, ngase tek lloji i dërgesës nuk është specifikuar lloji i dërgesës e cila i është dërguar debitorit, por vetëm mban mbishkrimin “R- AR,” andaj si e tillë nuk mund të konsiderohet se debitori i janë dorëzuar në mënyrë të rregullt faturat.

Gjykata po ashtu i vlerësoi edhe pretendimet e kreditorit se debitori e ka pranuar borxhin sipas komunikimeve në email, të cilat i ka bashkangjitur propozimit për përmbartim, mirëpo gjeti se përmes komunikimeve rezulton se kreditori nuk i ka specifikuar numrat e faturave, po ashtu i njëjti përmes email-it ka kërkuar përmbushjen e borxhit në shumë prej 6,171.69 €, ndërsa me propozim për përmbartim sipas faturave të cilat janë objekt i kësaj procedure përmbartimore ka kërkuar përmbushjen e borxhit në shumë prej 6,112.69 €, andaj nuk mund të konsiderohet se debitori ka pranuar borxhin sipas faturave të cilat janë objekt i kësaj procedure përmbartimore.

Andaj duke qenë se nuk ka prova se debitori i ka pranuar në mënyrë të rregullt faturat, rezulton se faturat e tillë nuk mund të shërbejnë si dokumente të besueshme dhe nuk kanë tipare të përmbartueshmërisë, përderisa njëra palë procedurale – debitori nuk ka pranuar një detyrim që rrjedh nga faturat.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat vlerëson se në rastin konkret dokumenti i besueshëm mbi të cilën mbështetet propozimi për përmbartim, e mbi bazën e të cilës Përmbartuesi Privat ka lejuar përmbartimin, nuk ka tipare të përmbartueshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbartuesit duhet të anulohet dhe procedura të përfundojë në tërësi.

Gjykata në kuptim të nenit 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.289/24, datë 30.07.2024

Gjyqtarja
Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.